



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. 575

Tiranë 1/7/2025

VENDIM

Nr. 26, datë 1.7.2025

PËR
MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM TË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR PERIUdhËN 2025 - 2028,
SI DHE TË PLANIT VJETOR PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM TË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2025

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “j”, të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 11, pika 1 dhe pika 4, shkronja “a” të Rregullores “Për Kartën e Auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendim Qarkullues të Këshillit Drejtues nr. 16, datë 30.04.2020, të ndryshuar, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe me propozim të audituesit të brendshëm të specializuar Grant Thornton sh.p.k., Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit strategjik për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për periudhën 2025-2028, si dhe të planit vjetor për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2025, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Grant Thornton sh.p.k në cilësinë e audituesit të brendshëm të specializuar, për zbatimin e këtij vendimi.





3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tianda Kaçi

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

